



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
31.05.2024

Me datë 31.05.2024, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqejza, Edmond Ndou, Hilmi Lakti, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gëzim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Irena Shala, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Gjenarin Kapcari, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Gjovalin Ndoj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Marina Duhani, Blendi Gjylbegaj, Gloria Shllaku, Anita Amuli, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për emërimin e sekretarit të Këshillit bashkiak, Shkodër"*
2. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2024"*.
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2023, të Bashkisë Shkodër"*.
4. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e planit vendor të veprimit për energji dhe klimë 2023-2030"*.
5. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB-në nr.7 datë:31.01.2024 "Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit" "Banesa sociale me qira" për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë" për vitin 2024"*.
6. Pr/ Vendim: *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*.
7. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e vjeljes, mbjedhjes, grumbullimit dhe shitjes me procedurë ankandi publik të prodhimeve të dyta pyjore të boçeve të pishës, rrënjëve të shqopës, bimëve mjekësore tanifere dhe eterovajore natyrore (MTE) për vitin 2024"*.
8. Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për vitin 2023.

9. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **41** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për emërimin e sekretarit të Këshillit bashkiak, Shkodër”*

Z.Luli lexon relacionin e përgatitur dhe fton këshilltarët të votojnë Znj.Danaj si kandidatë e zgjedhur si sekretare e Këshillit bashkiak.

Përpara se të hidhet në votim fjalën e merr **Z.Bjanku** i cili shprehet se në lidhje me votimin, ai në bazë të rregullores së vetë Këshillit duhet të bëhet i fshehtë, këtu **Z.Luli** sqaron duke thënë se mbështetur në ligjin 139/2015 për qeverisjen vendore votimi i sekretarit të këshillit bëhet i hapur.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro kandidatës së Znj.Danaj , në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort kurse Znj.Shala për grupin BF abstenon ndërsa për grupin PD Z.Gjylbegaj shpreh dakortësi.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **30** vota Pro. **0** Kundër. **11** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2024”*.

Kryetarët e grupeve, shprehen dhe bien në dakortësi se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativim pasi është i përmuajshëm. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **41** vota Pro. **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 3. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit viti 2023, të Bashkisë Shkodër”*.

Relaton për pr/vendimin në fjalë **Znj.Mjeda**, drejtoreshë, drejtorja e Financës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Bajraktari merr fjalën dhe kërkon të dijë në lidhje me zërin, llogari të arkëtueshme në pr/vendim. Aty thuhet, shton ajo se shuma nga 1.7 miliard ka shkuar në 2.2 miliard lek, çfarë konstaton kjo rritje sepse nuk është e paraqitur në relacion. E njëjta gjë është edhe tek zëri i debive.

Përgjigjet **Znj.Mjeda** dhe sqaron se në lidhje me debitorët ka rritje pasi bëhet fjalë për gjokat e IMT-së, kamatë vonesat dhe përqindjet ndër vite.

Përsëri **Znj.Bajraktari** kërkon të dijë se çfarë parashikon rritja e paraqitur tek fondi i konsoliduar, tek shuma e parashikuar e zhvlerësimeve në një kohë që kjo shumë në 2020 ka qënë 0? Tjetër pyetje është në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve nga drejtoria ekonomike e arsimit, ku vlera neto është 6 milion lek, pse këto objekte janë nxjerrë jashtë përdorimi në një kohë që janë vetëm 13% të amortizuara, pra pothuajse të reja?

Përgjigjet përsëri **Znj.Mjeda**, duke sqaruar se në këtë rast kemi të bëjmë me inventar të imët, ekonomik të kryer mbi bazën e udhëzimit nr.30, siç e parashikon ligji, njësia përkatëse nxjerr një urdhër i cili hartohet nga Kryetari me grupin e punës për inventarizim dhe vlerësim.

Znj.Mehmetaj merr fjalën dhe ka një pyetje në lidhje me detyrimet e trashëguara që nga viti 2015 për shkak të ndarjes së re territoriale administrative. A ka Bashkia Shkodër ndonjë plan masash ose arkëtimi për to, pasi ato vazhdojnë të trashëgohen?

Znj.Blerta shprehet se kjo është e vërtetë që me ndarjen e re territoriale Bashkia Shkodër trashëgoi, sidomos nga njësia Rrethina dhe Velipoja një borxh të konsiderueshëm. ku pjesa më e madhe janë vendime gjyqësore të cilat janë në proces dhe shpresojmë të jenë në favor të Bashkisë. Pjesa tjetër e këtyre borxheve janë detyrime financiare janë me fatura me probleme, për të cilat nuk mund të vijojmë me likuidimin. Po ashtu ajo shton se bëhet fjalë për bilancin e një viti të tërë dhe pyetjet e drejtuara do marrin përgjigje patjetër.

Znj.Shala merr fjalën dhe kërkon të dijë më shumë rreth auditimit të kryer dhe rekomandimeve të lëna.

Znj.Mjeda thotë se një nga pikat kryesore të pasqyrave të konsoliduara është edhe paraqitja përmbledhëse e asaj çfarë ka dalë nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm. Ne mund t'iu vëmë në dispozicion këtë informacion, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave.

Z.Bjanku shprehet se pr/vendimi dhe prezantimi sipas tij duhet të bëhet më i thjeshtë nga terminologjia dhe më i aksesueshëm për qytetarët.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **32** vota Pro, **11** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për miratimin e planit vendor të veprimit për energji dhe klimë 2023-2030".

Relaton për këtë pr/vendim **Znj.Shllaku**, drejtoreshë, drejtoria e Mjedisit në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.I.Sokoli merr fjalën dhe shprehet se materiali i paraqitur nuk është i saktë përse i përket terminologjisë.

Znj.Shllaku sqaron se plani është i përgatitur në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe specialistë të fushës. Dhe në momentin që ky plan miratohet do redaktohet në versionin përfundimtar për zbatim.

Znj.Pode shprehet gjithashtu se plani do jetë shumë përfitues për qytetarët e Bashkisë Shkodër jo vetëm për emetimin e gazrave të dëmshme por edhe për kursim energjie dhe zhurmat në qytet.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **34** vota Pro, **4** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për një ndryshim në VKB-në nr.7 datë:31.01.2024 “Për miratimin e listës së përfituesve për programin social të strehimit” “Banesa sociale me qira” për instrumentin financiar “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” për vitin 2024”.*

Edhe në këtë pikë këshilltarët shprehen dhe bien në dakortësi se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativ pasiguri bëhet fjalë vetëm për një gabim material. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **38** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e radhës: Pr/ Vendim: *“Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*

Edhe në lidhje me pikë. këshilltarët shprehen dhe bien në dakortësi se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativ pasiguri procedura është e njohur tashmë. Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **38** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 7. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e vjeljes, mbjedhjes, grumbullimit dhe shitjes me procedurë ankandit publik të prodhimeve të dyta pyjore të boçeve të pishës, rrënjëve të shqopës, bimëve mjekësore tanifere dhe eterovajore natyrore (MTE) për vitin 2024”.*

Relaton edhe për këtë pr/vendim **Znj.Shllaku**, drejtoreshë, drejtorja e Mjedisit në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje dhe diskutime nuk ka. Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr/vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika 8: Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për vitin 2023. Relaton për këtë pikë **Z.Luli**, sipas materialit të përgatitur dhe njeh Këshilltarët mbi punën e kryer nga këshilli.

Vijohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Znj.Duhani** e cila shprehet se ndër pikat e forta të mandatit të Kryetarit ka qënë sistemimi i hyrjes së Shkodrës. Me ardhjen e sezonit turistik fillon edhe shqetësimi për trafikun e rënduar aty. Po ashtu ajo shprehet në lidhje me fasadat e pallateve duke thënë se hyrja e shkodrës është nga Lgj.Perash dhe jo nga Lgj.Xhabije, prandaj duhet të shihet ndërhyrja edhe në këtë pjesë. Ajo shpreh pakënaqësi edhe persa i perket ndriçimit të vendosur në lagjen me të frekuentuar të Shkodrës “Gjuhadol”.

Përgjigjet **Z.Bejlari** duke thënë se persa i përket fasadave, nuk është ndërhyrë kudo, por në mënyrë të mirë studiuar dhe në bazë kriteresh.Është marr një aks shumë i rëndësishëm i qytetit. Do vazhdohet me ndërhyrje dhe për çdo gjë vendimi do merret në Këshill. Kurse ndriçimi që po realizohet në Gjuhadol është në bashkëfinancim me qeverinë zvizerane, është ndriçim i varur dhe shumë cilësor. Në lidhje me hyrjen e Shkodrës , shton ai projekti vazhdon, është kompleks dhe nuk mund të mbaroj sa hap e mbyll sytë.

Z.Shkjau gjithashtu shprehet në lidhje me hyrjen e qytetit duke thënë se është një imazh i shëmtuar , sidomos pjesa tek “Bexhesteni”. Prandaj duhet të ketë përparësi.

Z.Pashuku merr fjalën dhe flet në lidhje me ndërtimin e autostradës adriatiko-joniane. Ai shprehet se në dëgjesën e fundit me banorët e zonës ka patur shumë pak prezencë. Ai mendon se dëgjesat duhen të kryhen në Nj.Adm. përkatëse, pasi banorët eaty janë direkt të prekur nga kjo rrugë dhe nga mungesa e informacionit kanë pakënaqësi.

Z.Bejlari përgjigjet duke sqaruar se dëgjesa publike është bërë për ndikimet në mjedis që do ketë kjo autostradë dhe akoma nuk jemi në fazën e detajimeve për shpronsimet dhe hyrje daljet për në qytet. Ne si bashki kemi bërë një kërkesë zyrtare për tu rishikuar edhe njëherë atë çka prek kjo rrugë edhe në lidhje me hyrje-daljet. Ai garanton se do merret në konsideratë çdo problematikë dhe shqetësim i mundshëm.

Znj.Leqejza merr fjalën dhe thotë që përfitimet e kësaj rruge do jenë padyshim shumë të mëdha në krahasim me tokat, produktet e çdo gjë tjetër që mund të preken nga kjo.

Znj.Pode merr fjalën dhe shprehet në lidhje me disa shqetësime qytetare. Së pari ajo ajo thotë se ura e vjetër e Bunës është amortizuar dhe kjo mund të sjelli rrezikshmëri. Po ashtu edhe përdorimi i monopatinës pa kriter, po një disiplinim në qarkullim po krijon probleme. Tjetër shqetësim i saj është pjesa e varrezave të vjetra të qytetit në rrugën drejt Koplikut, të cilat janë një imazh i pakëndshëm për turistët që vijnë.

Përgjigjet **Z.Bejlari** duke shprehur dakortësi me problematikat e shtruarat. Ai shton se po mendohet të ketë një limitim moshe për përdorimin e monopatinës dhe masat mbrojtëse. Kurse në lidhje me rregullimin e infrastrukturës në rrugën e përmendur do merren masa për ndërhyrje.

Fjalën e merr **Znj.Shllaku** duke u shprehur në lidhje me projektin e vendosur në hyrje të qytetit. Ajo mendon se në bazë të ligjit duhet të ishte marrë mendimi i grupeve të interesit dhe qytetarëve për vendosjen e çelsit aty.

Z.Bejlari përgjigjet duke thënë se bëhet fjalë për një projekt të Ministrisë së Ekonomisë , Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me ambasadën italiane. Kemi të bëjmë me një grup monumentesh që po vendosen në akset kryesore të Shqipërisë. Pjesë e tyre është edhe çelsi, simbolikën e të cilit mund ta sqarojë më së miri autori i veprës.

Përsëri **Znj.Shllaku** shton se projekti është fitues për tu vendosur në rreth rrotullimin e Hanit të Hotit. Pse vendi i vendosjes ka ndryshuar dhe nga kush është marr vendimi?

Z.Bejlari sqaron se është thjesht arredim urban që nuk është parë e arsyeshme të bëhet një konsultim publik.

Edhe **Znj.Shkrela** shprehet gjithashtupër problematikat e sipër përmendura, duke shtuar se ajo mendon se kjo është një formë arrogance e të shprehurit të kësaj Bashkie. Qytetarët e Shkodrës duhet të respektohen duke dëgjuar zërin e tyre dhe jo të merren vendime sipas vizionit që thonë ju.

Z.Ndou merr fjalën dhe shprehet se nuk mendon se është koha për tu marr me bojatisje dhe çelsa por ka ardhur koha të flitet për investimet e munguara prej kohësh për Shkodrën.

Fjalën e merr **Znj.Kopshti** kërkon të dijë se kur do marri vemendjen e duhur për investime Ana e Malit?

Përgjigjet përsëri **Z.Bejlari** duke thënë se shumë shpejt do ketë një fazë të re ndërhyrjesh. prej të cilave përfituese do jetë edhe Ana e Malit.

Z.Doci merr fjalën dhe shpreh shqetësimin e tij në lidhje me gjobat e Policisë Bashkiake. Po ashtu ai shton se tjetër shqetësim është prishja e beach-bareve një muaj para sezonit turistik. A keni patur ndonjë reagim si Bashki ndaj Ministrisë për këtë? Po lejet e ndërtimit, kërkon të dijë ai kur do zhblllokohen?

Përsëri **Z.Bejlari** sqaron se përse i përket menaxhimit të beach bareve e cdo gjeje në pjesën ranore autoriteti menaxhues është Ministria dhe IKMT. Padyshim që Bashki ka patur reagimet e veta dhe po shtymë procesin për dhënien e lejeve dhe standartizimin. Kurse në lidhje me lejet e ndërtimit, ato nuk janë bllokuar, kushdo që aplikon dhe përmbush kriteret e vendosura mund të jetë përfitues.

Znj.Petani merr fjalën dhe shprehet në lidhje me çelsin e vendosur tek Bexhesteni, ajo mendon se kjo duhet të shihet e gjykohet nga profesionistë të fushës.

Znj.Shala shprehet se ne si zëri i qytetarëve të Shkodrës duhet të reagojmë dhe të njihemi me vendimet e marra nga Bashki Shkodër, për çdo gjë që ka të bëjë me qytetin.

Z.Behri po ashtu sjell shqetësimet në lidhje me mbarëvajtjen e sezonit turistik në Velipojë. Ai shprehet se duhet patjetër të bëhet dezinfektimi për insektet dhe mirëmbajtja e ËC publike. Tjetër sugjerim është edhe zhvillimi i aktiviteteve artistike për gjallërimin e jetës së natës në Velipojë.

Z.Bejleri falenderon për sugjerimet e Z.Behri dhe shton se patjetër që do kryhen ndërhyrjet e domosdoshme dhe do ketë po ashtu aktivitete artistike siç janë zhvilluar në fund vit në qytet.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Z.Luli e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 31.05.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 8 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

KRYETAR



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti